

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

# PROGRAMI I LËNDËS SË TEATRIT DRAFT

SHKALLA E DYTË DHE E TRETË



Nëntor, 2014

## Përbajtja e Programi

I.	Hyrje .....	5
II.	Korniza konceptuale e programit.....	7
1.	Qëllimet e programit të teatrit.....	9
2.	Lidhja e kompetencave kyçë me kompetencat e fushës .....	9
3.	Lidhja e teatrit me temat ndërkurrikuare .....	12
4.	Lidhja e teatrit me fushat e tjera kurrikulare .....	13
5.	Kompetencat e lëndësdhe tematikat e saj .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6.	Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë.....	18
III.	Përbajtjae shkallës së dytë dhe të tretë.....	19
1.	SHKALLA E DYTË .....	19
1.1	Tematika : Gjuha dhe komunikimi teatror .....	20
1.2	Tematika: Teknika dhe procese teatrore .....	23
1.3	Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria.....	25
2.	SHKALLA E TRETË.....	28
2.1	Tematika : Gjuha dhe komunikimi teatror .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.2	Tematika: Teknika dhe procese teatrore .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
2.3	Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
IV.	Udhëzime metodologjike .....	42
V.	Udhëzime për vlerësimin .....	44
VI.	Materiale dhe burime mësimore.....	45

## **Tabelat dhe diagramet**

Digrama 1:Korniza konceptuale e programit .....	8
Digrama 2: Rezultatet e të nxënittë komptencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së teatrit për shkallën e dytë dhe të tretë....	11
Digrama 3:Lidhja ndërmjet teatrit dhe fushave të tjera. ....	14
Digrama 4 : Kompetencat e lëndës dhe tematikat e lëndës. ....	16
Tabela 1: Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës .....	17
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	18

Fusha e arteve është pjesë e rëndësishme e kurrikulësnë të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, kundërveprojnë kultura dhe shoqëria.

Mësimi i arteveu afrom nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe zhvillimin e njohurive artistike përmes kuptimit të tyre nëpërmjet mjeteve shprehëse si: tingujve, ngjyrave, fjalës, lëvizjeve, të cilat mësohen, formohen dhe kultivohen përmes teknikave dhe proceseve artistike, nëpërmjetzbullimit dhe praktikës artistike, të cilat nxitin të mësuarit konkret të artit, gjatë procesit mësimor në shkollë dhe në jetën e përditshme. Artet ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave që u shërbejnë individëve në aspektin personal, social dhe ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. Kompetencat që zhvillon fusha e arteve në të gjitha shkallët kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyç, në funksion të të nxënëtit gjatë gjithë jetës. Fusha e arteve zhvillohet përmes lëndëve: *art pamor, muzikë, kërcim* dhe *dramë* si lëndë të detyrueshme në **shkallën 1, shkallën 2 dhe shkallën 3**. Fusha e arteve **në shkallën e parë** fokusohet në ndërgjegjësimin e nxënësve për njohjen e dukurive, fenomeneve, objekteve dhe situatave artistike në mjeshterin që ata i rrethon. **Në shkallën e dytë dhe të tretë**, fusha e arteve fokusohet në aftësimin e nxënësve në vëzhgimin, reflektimin, komunikimin dhe përdorimin e informacionit nga burime të ndryshme. Artet janë konceptuar në funksion të të nxënëtit gjatë gjithë jetës dhemundësitë enxënësve për të njohur gjuhën artistike të arteve, për të realizuar, për të prezantuar punë të ndryshme artistike, për të vlerësuar veprat e arteve të ndryshme. Artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën dhe kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit, ndihmojnë në krijimin dhe zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar, nëpërmjet elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare sidhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve.

## I. Hyrje

Teatri është një nga artet më të vjetra në botë dhe sado që deri në fillim të shkullit të shkuar është parë si një art që përmblidhte bashkë fjalën e interpretuar, muzikën, artet pamore dhe të tjera elemente artistike, antropologët dhe shkollat moderne të teatrit e shohin gjithmonë e më shumë këtë gjini artistike si një rrjedhojë të natyrshme njerëzore, e cila buron drejtpërsëdrejti nga rituali. Njeriu ka një nevojë të brendshme për të shkuar tek teatri, ai ka nevojë të krijojë art me trupin e zërin e tij dhe një realitet artistik ku të shfaqë probleme madhore, si një mjet spastrimi ose argëtimi të mirëfilltë, ai ka nevojë ta shohë botën me sytë e tjetrit dhe të shpërndajë mesazhe përmes fjalës së përpunuar artistike. Teatri ka qenë gjithmonë i lidhur ngushtë me zhvillimin njerëzor, në cilëndo fazë të zhvillimit shoqëror apo në çfarëdo terreni kulturor. Ai gjithmonë ka qenë pjesë e proceseve historike, duke u lidhur ngushtë me politikën, filozofinë, psikologjinë dhe artet e epokave të ndryshme historike.

Këto tipare të teatrit e bëjnë atë të jetë sa i natyrshëm për të gjithë, aq edhe i ndërlikuar kur është në formën e tij më të zhvilluar, ndaj kur ndërthuret me proceset e arsimimit është një ndihmë e madhe për kulturën e secilit individ dhe të shoqërisë në përgjithësi. Një nxënës që e njeh teatrin di ta vlerësojë dhe do ta vlerësojë atë edhe në të ardhmen, ai është në gjendje të marrë mesazhet e duhura dhe emocione të plota kur ndjek një shfaqje, madje një takim që në vogëli me teatrin ndez në individë të caktuar edhe dëshirën për t'u marrë me teatër, në një kohë kur kjo prirje nuk nxitet në asnje formë tek të rinjtë, përvçese nga familja.

Njohja e teatrit mbart një vlerë të madhe në zhvillimin e personalitetit të nxënësve, të aftësisë së tyre për të punuar në grup, për të konsideruar mënyrën si e sheh botën tjetri, për të folur në mënyrë të denjë në publik dhe për të zhvilluar prirjet e tyre artistike, krijuese e kritike.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është lidhja e teatrit me të gjitha lëndët e tjera brenda fushës së arteve dhe fushat e tjera të kurrikulës, si dhe me temat ndërkurrikulare, me qëllim që të zotërohen sa më mirë *kompetencat kyçë*. Teatri është emëruesi i përbashkët i një sërë elementesh artistike: letërsisë (lënda që interpretohet), pikturës (skenografi, kostume), muzikës, ndriçimit, imazheve pamore, etj. Për këtë arsyе ka nevojë për marrjen e disa njohurive themelore që lidhen me këto elemente dhe me tipare të tjera të veçanta të interpretimit artistik, duke i bërë nxënësit të vetëdijshëm për këtë gjini artistike dhe duke zgjeruar njohuritë e tyre.

Veprimtaritë e ndryshme teatrore e çojnë nxënësin të interpretojë teknikisht e me shije materiale të ndryshme letrare, të përdorë aftësitë e tij fizike e krijuese për të përcjellë mesazhe, për të krijuar karaktere dhe realitetë artistike që ngrihen në një shkallë më lart se realiteti.

Teatri, duke qenë specifik, kërkon disa dije bazë për ta kuptuar dhe shijuar, pra është një lëndë që nuk mund të ofrohet që në fazat e para të fëmijërisë. Në moshën 11-12 vjeçare, kur fëmija po del nga loja, po hyn në adoleshencë dhe po krijon personalitetin e tij në shoqëri, ai po kalon fazën që ngjasojnë shumë me një rol skenik, ku fëmija përpinqet të ruajë tiparet e tij, por edhe të përshtatet me ambientin që e rrethon. Kjo është mosha kur fëmija fillon të krijojë qëndrimet e tij ndaj botës dhe filozofive në botë dhe teatri është mjeti më i mirë që i tregon lidhjen mes lojës fëminore e ritualit primitiv, drejt një arti e mardhënieje më të ndërlikuar siç është tetari dhe mundësia krijuese që të jep ai duke përdorur gjithë kapacitetin njerëzor të fjalës, trupit dhe gjinive të ndryshme krijuese. Nëpërmjet këtyre orëve fëmija mëson edhe konceptet bazë si *përqendrimi, artikulimi i fjalëve, fuqia bindëse e tyre (oratoria dhe të folurit publik), besimi në lojë si aktor, hapësira artistike, fuqia artistike për të përcjellë mesazhe dhe për shpalosur atë që kemi brenda vetes, konvencionin artistik*. Duke e përjetuar teatrin nga vetë skena, ai do të fillojë të vlerësojë edhe më mirë këtë lloj gjinie, kënaqësinë që marrim prej teatrit dhe do të ketë një gjykim kritik ndaj punëve skenike, që do të shohë në të ardhmen.

Lënda e teatrit synon t'i edukojë dhe formojë nxënësit nga pikëpamja teatrore, duke i orientuar ata nëpërmjet vetëzbulimit drejt kuptimit të veçorive të gjinisë teatrore nga më e thjeshta tek më e ndërlikuara, përmes gjuhës dhe tipareve të komunikimit teatror, por edhe duke marrë pjesë individualisht e në grup në realizimin e veprave teatrore<sup>1</sup>, për të krijuar vlerësimin dhe qëndrimin artistik, në njohjen e teatrit shqiptar dhe botëror, përmes materialeve të ndryshme të interpretueshme.

Mësimi i teatrit në shkollë lidhet me njohjen, të kuptuarit dhe zbatimin e koncepteve e teknikave të teatrit dhe interpretimit të fjalës. Teatri në shkollë lidhet jo vetëm me zhvillimin e aftësive dhe shkathësive, por edhe një mënyrë të menduarit e të vlerësuari përmes dijeve të tyre mbi teatrin.

<sup>1</sup>Vepër teatrore do të quhen të gjitha pjesët teatrore ku hyjnë edhe punët e fëmijëve, ku konkretishtata fillojnë me lojën dhe kulmohen me vënien ne skenë të një pjese të thjeshtë dramaturgjike.

## **II. Korniza konceptuale e programit**

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyçë të të nxënët gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të lëndës së teatrit, në mënyrë që ata të përballojnësfidat e jetës dhe të integrohen lehtësisht në shoqëri.
- **Mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit**, për njohjen e rezultateve e pritshmetë fëmijëve dhekriteret e vlerësimitnë periudha të caktuara.
- **Hartuesittë** teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.


Programi i teatrit ka në thelbin të tij krijimin e kushteve për ndërtimin **ekompetencave të lëndës** si dhe të kompetencave kyçë që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet lëndës së teatrit është një përbërës irëndësishëm i programit për kontributin e teatrit dhe të gjitha arteve të tjera, që përbëjnë fushën e arteve, në shoqëri dhe në jetën e përditishme. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e teatrit me fushat e tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi, përmban edhe **tri tematikat** të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçë. Në program paraqiten edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie në teatër është kusht parësor për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik, që zotëron brenda vetes. Në këtë program **vlerësimi i nxënësve**, është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënët.

Programi i teatrit, nga pikëpamja e organizimit të përbajtjes, paraqitet në diagraminë poshtëm:

Diagrami 1: Korniza konceptuale e programit



## **1. Qëllimet e programit të teatrit**

Programi i teatrit, nëpërmjet përbajtjes të përcaktuar sipas tematikave ka si qëllim zhvillimin e njohurive dhe koncepteve bazë për formimin artistik në teatër, të kuptuarit dhe të vlerësuarit e elementeve teatrore që na rrrehojnë, zhvillimin e aftësive interpretuese, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve, aftësimin e nxënësve për të njohur dhe vlerësuar vepra të teatrit shqiptar dhe botëror, nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike, përfshirjen në veprimitari teatrore tradicionale apo skenike, duke manifestuar vlerat e materialeve të interpretueshme kombëtare si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, pjesëmarrien në jetënkulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke i vënë në shërbim të mjesdit ku jeton, aftësitë dhe talentin e vet, ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike, zhvillimin e kompetencave teatrore për tëkrijuar dhe realizuar pjesë të ndryshme të kësaj gjinie, dhënien e kontributit personal në zhvillimet artistike teatorenë nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Në programin e teatrit nxënësi mëson të zbulojë ngjashmëritë, ndryshimet mes gjinive teatrore, natyrën shkak-pasoje të marrëdhënieve njerëzore, eksperimenton interpretimin nëpërmjet trupit dhe zërit të vet, hulumton punën në grup dhe kupton rëndësinë e ndërvartësisë nga njëri-tjetri. Ai kuption dhe argumenton qëndrimet e veta, duke ua paraqitur të tjereve, mësohet të vlerësojë e të respektojë edhe qëndrimet e të tjereve, arrin të krijojë siguri në komunikimin publik dhe të jetë bindës, madje të ndihet i suksesshëm në teatër.

## **2. Lidhja e kompetencave kyçë me kompetencat e fushës**

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçegjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyçë, me kompetencat e lëndës për secilën shkallë, të mbajë parasysh lidhjen ekompetencave kyçë, me kompetencat e fushës/lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e

përshtatshme të procesit tënës. ***Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.*** Organizimi i mësimit të teatrit me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktëdhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencat teatrore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçë. P.sh.: kompetenca e teatrit “Interpretim i veprave teatrore” përfshin teknika të ndryshme të interpretimit, të zhvillimit të aftësive krijuar nëpërmjet elementeve teatrore apo të zhanreve të këtij arti, të cilat fëmijët mund t'i përdorin edhe në jetën e përditshme.

Duke zhvilluar kompetencat teatrore, nxënësi zhvillon edhe kompetencat kyçë në lidhje me krijimtarinë, interpretimin, vlerësimin e teatrit e letërsisë, përpunimin e informacionit për teatrin, prezantimin e detyrave të zhvilluara, punën në grup, komunikimin efikas, të folurën publike, etj. Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçë me kompetencat e lëndës së teatrit, mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënës për kompetencat kyçë, që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për secilin vit mësimor rezultatin/ete të nxënës për shkallë, për kompetencat kyçë;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënës për shkallë për kompetencat e lëndës së teatrit që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së teatrin për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënës për shkallë;
- përzgjedh përbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënës të kompetencave teatrore në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënës për kompetencat kyçenë një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënës brenda viti shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësimë të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënës për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e teatrit;
- stimulon nëpërmjet artit gjithëpërfshirjen edhe të atyre nxënësve që nuk arrijnë rezultate të larta akademike, por që shpesh tregojnë aftësi të veçanta në të tilla lloj aktivitetesh, duke qenë të çliruara nga ngurtësia akademike dhe të prirur për ta shfaqur pa frikë natyrën e tyre të vërtetë.

**Diagrami 2: Rezultatet kryesore të kompetencave kyçë që realizohen nëpërmjet lëndës së teatrit për shkallën e dytë dhe tretë**

<b>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike.</li> <li>• Kupton mesazhet që i drejtohen.</li> <li>• Shprehet në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve, elementeve, kodeve dhe formave artistike.</li> <li>• Komunikon me efikasitet dhe shfrytëzon në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mundësitet e të shprehurit.</li> </ul>
<b>Kompetenca e të menduarit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mendon në mënyrë krijuese.</li> <li>• Merr dhepërpunon njohuritënë mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi.</li> <li>• Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.</li> <li>• Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimitari.</li> </ul>
<b>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim skenik.</li> <li>• Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim skenik.</li> <li>• Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</li> </ul>
<b>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete skenike brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.</li> </ul>
<b>Kompetenca personale</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillon besimintek vetja gjatë krijimit skenik.</li> <li>• Zhvillon aftësinë e të folurit publik dhe të të qenit bindës.</li> <li>• Mëson të punojë në grup dhe kupton rëndësinë e disiplinës.</li> <li>• Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.</li> <li>• Mëson ta shohë botën dhe të tjerët nëpërmjet këndvështrimeve të ndryshme, duke hyrë më “këpucët e tjetrit”.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>Zhvillon shije artistike e kritike.</li> </ul>
<b>Kompetencia qytetare</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Diskuton dhe bashkëpunon me të tjërët për çështje të ndryshme kulturore.</li> <li>Zbaton rregullat e teknikave të interpretimit, konvencionit, të krijimit.</li> <li>Reflekton qëndrim kritik ndaj artit dhe e shfrytëzon atë për të marrë e dhënë mesazhe shoqërore.</li> </ul>
<b>Kompetencia digjitale</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Njeh dhe përdor mjetet audio, video, ndriçimi, CD, DVD, laptop etj.</li> </ul>

### 3. Lidhja e lëndës së teatrit me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore, me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Teatri lidhet me një shumëllojshmëri të veprimtarivenë jetën e përditshme dhe me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë, sepse ai vetëm merr në konsideratë shumë nga këta komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; të drejtat e njeriut; bashkëjetesa paqësore*, nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve teatrore, duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grupnë aktivitete të ndryshme duke dhënë kontributin e vet, duke dhënë zgjidhje situatave dhe problemeve të ndryshme teatrore/artistike, duke përdorur gjuhë të saktë teatrore për të komunikuar vlera dhe qëndrime, duke shpjeguar teknika dhe procese të ndryshme skenike, që lidhen dhe me fusha të tjera që ata mësojnë. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave teatrore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësipërdor aftësitë e tij teatrore që kanë të bëjnë me simbole, konvencione skenike, kostumografi e rekuizitë, duke krijuar një marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë elementet e një shfaqjeje skenike, çfarë tiparesh teatrore kajeta e tyre dhe ndërvarësitë e mjedisit dhe botës njerëzore (loja, rituali, marrëdhëni njerëzore, shkak-pasoja).

Nxënësi mëson të mprehë dëgjimin, vëmendjen dhe të komunikojë përmes një gjuhe të zhvilluar dhe elementeve artistike, për të kriuar një pjesë teatrore/skenike, duke përdorur elementet dhe parimet egjuhës teatrore, duke eksperimentuar me elemente të tjera artistike që lidhen me teatrin, duke organizuar krijimin e vet teatrор, sipas larmisë së mjeteve skenike.

Nxënësi fillon të familjarizohet me përbajtje të ndryshme të veprave teatrore/skenike, duke zbatuar teknika dhe procese të ndryshme, duke respektuar rregullat e interpretimit skenik, duke ndarë përvojat e veta interpretuese me të tjerë dhe duke interpretuar mënyrë artistike.


Nxënësi analizon veprat teatrore të interpretuara, duke gjykuar dhe shpjeguar kuptimin e tyre, çka sjell një qëndrim kritik dhe estetik ndaj teatrit dhe kulturës në përgjithësi.

#### **4. Lidhja e lëndës së teatrit me fushat e tjera kurrikulare**

Teatri është domosdoshmërisht i lidhur me lëndët brenda fushës së tij, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikula.

Elementet teatrore si interpretimi, skenografia, muzika, kostumet, ndriçimi, etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si kërcimi, arti pamor, muzika, por edhe me letërsinë, gjuhën, shkencat shoqërore, biologjinë, fizikën, etj. Ndaj mësuesi synon që ta nisë lëndën nga ato që fëmija tashmë i njeh dhe teksa i çon drejt zbulimit të mëtejshëm, u shpjegon edhe lidhjet me ato që fëmijët po zbulojnë. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlindore të teatrit me lëndë të tjera, të para përmes objektivave të njojurive:

**Diagrami 3: Lidhja ndërmjet teatrit dhe fushave të tjera**



## **5. Kompetencatqëformohenpërmestemistikave**

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e teatrit synon të përbushë 3 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyç, që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore.

*Kompetencat e lëndës:*

Kompetenca 1: Krijimi i veprave teatrore.

Kompetenca 2: Interpretimi i veprave teatrore.

Kompetenca teatrore 3: Vlerësimi i veprave teatrore.


*Tematikës e lëndës:*

Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi teatror.

Tematika 2: Teknikat dhe proceset teatrore.

Tematika 3: Historia, teatri dhe shoqëria.

Digrama4 : Kompetencat që formohenpërmes tematikave



**Tabela 1: Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës**

Kompetencat e veçanta që formohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Realizimi nëpërmjet tematikave
<b>Krijimi i veprave teatrore</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përdoride të ndryshme për të organizuar dhe qartësuar mendimin teatrор.</li> <li>- Përdorelementet dhe gjuhën të interpretimit, eksperimenton dukezbuluar dhe zhvilluar më tejidetë e veta artistike.</li> <li>- Organizon krijimin e vet në gjininë e teatrit, sipas elementeve të gjuhës teatrore, ose të elementeve të tjerë që përfshin ai (muzikë, arte pamore, etj.).</li> <li>- Ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbulon gjininë</li> <li>- logjikën</li> <li>- konvencionin</li> <li>- ngjarjen</li> <li>- shkak-pasojën</li> <li>- psikologjinë</li> <li>- besimin tek loja</li> <li>- të folurën publike</li> <li>- të qenët bindës</li> <li>- punën në ansambël</li> <li>- disiplinën skenike dhe rëndësinë e saj, etj.</li> </ul>
<b>Interpretimi i veprave teatrore</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Familjarizohet me përbajtje të ndryshme të veprave teatrore (lojëra, rite, pjesë të shkurtra letrare, pjesë dramaturgjike).</li> <li>- Zbaton teknika dhe procese të ndryshmeinterpretimi.</li> <li>- Respektonrregullat dhe disiplinën e interpretimit skenik gjatë lojës skenike apo mbështetjes teknike.</li> <li>- Ndan përvojat e veta skenike me të tjerë.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton teknikën vokale të të folurit publik</li> <li>- zbaton teknikën e aktrimit në rrobën e personazhit</li> <li>- zbaton theksin logjik në përcjelljen e një mesazhi të caktuar apo të një tjetri</li> <li>- zbulon nëntekstin e fjalëve që përdorim në bisedë</li> <li>- ushtron të dëgjuarin dhe vëmendjen konkrete</li> <li>- përjeton shkollat e historinë e interpretimit gjatë zbulimit të tyre.</li> </ul>

<b>Vlerësimi i veprave teatrore</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizon vepra të thjeshta teatrore, duke i shpjeguar ato.</li> <li>- Mban një qëndrim kritik dhe estetik.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- reagon emocionalisht ndaj veprave teatrore përmes përjetimit, shikimit, krijimit dhe interpretimit, duke përjetuar dhe shprehur përjetimet personale mbi një pjesë teatrore dhe përdorur gjuhën artistike.</li> <li>- prezanton punën e vet artistike, në veprimtaritë artistike të klasës apo të shkollës.</li> </ul>
-------------------------------------	--	---

## 6. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Lënda e teatrit zhvillohet për 54 orë mësimore, 18 orë për shkallën e dytë dhe 36 orë për shkallën e tretë. Programi i lëndës së teatrit specifikon kohën (orët e sugjeruara) të secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shumë orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që, përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore.

**Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

	Gjuha dhe komunikimi teatror	Teknikat dhe proceset e interpretimit	Historia, teatri dhe shoqëria	Gjithsej orë
<b>Shkalla e dytë (Klasa 5)</b>	6	8	4	<b>18 orë</b>
<b>Shkalla e tretë (Sem I / Klasa 6)</b>	6	8	4	<b>18 orë</b>
<b>(Sem II / Klasa 6)</b>	6	8	4	<b>18 orë</b>
<b>Total</b>	<b>18</b>	<b>24</b>	<b>12</b>	<b>54 orë</b>

### **III.Përbajtja e shkallës së dytë dhe të tretë**

Në programin e lëndës së teatrit për shkallën e dytë janë paraqitur përbajtjet e tematikave të teatrit:

- *Gjuha dhe komunikimi teatror.*
- *Teknikat dhe proceset e interpretimit.*
- *Historia, teatri dhe shoqëria.*

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar enjohuri, shkathtësi dhe qëndrime e vlera, për të siguruar rezultatet e të nxënës, sipas kompetencave teatrore, për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike.

Përse cilën tematikë, sipas klasave të shkallës janë paraqitur njohuritë për secilën:

- klasë të shkallës së parë (*klasa 5*);
- klasë të shkallës së dytë (*semestri I, klasa 6*);
- klasë të shkallës së tretë (*semestri II, klasa 6*).

Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten në nivel të se cilës shkallë.

Tematikat dhe renditja e tyre nuk supozojnë paraprakisht që përbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e koncepteve dhe shprehive teatrore në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (mësuesit dhe autorët e teksteve).

Për “përkthimin” e programit të shkallës në tekste mësimore apo programe lëndore për çdo vit mësimor, aftësitë dhe orët e tematikave do të jenë të shpërndara në kapituj/njësi mësimore të renditura logjikisht njëri pas tjetrit.

Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të tendryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduar për secilën tematikë.

Në program, për secilën klasë, afersisht 40% e orëve mësimore totale janë menduar për ndërtimin e njohurive të reja lëndore dhe 60% e tyre janë menduar përkrijimin e situatave të të nxënës (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

## **REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE**

### **SHKALLA E DYTË: KLASA E PESTË**

#### **1.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi teatror**

##### **Përshkrimi i tematikës:**

Zbulimi i sjelljeve të ndryshme shoqërore dhe “rolet” që luan njeriu në rrethana të ndryshme, që nga lojërat e fëmijërisë dhe ritualet për të kuptuar gjuhën dhe lindjen e teatrit. Kuptimi i elementeve teatrore, ndërtimi i njohurive të parambi elementet e teatrit, kombinimin e tyre në skenë çojnë në edukimin e nxënësve me interpretimin që në moshë të hershme, kur fëmijët luajnë dhe jo vetëm interpretojnë role të caktuara në lojë, por edhe i shkojnë konvencionit deri në fund me besim të sinqertë në të. Ata përveçse zhvillojnë ndjenjën e përdorimit të imagjinatës e aftësive vetjake përmes përjetimeve konkrete interpretuese, fillojnë të zhvillojnë edhe aftësinë për ta shpjeguar lojën skenike me fjalë të thjeshta. Procese të tilla si: zbulimi, përjetimi, dëgjimi, analizimi, interpretimi apo çfarëdo krijimi i lidhur me gjuhën teatrorë ndihmon nxënësit të zhvillojnë jo vetëm kompetencën e krijimit, por edhe të zbatimit konkret të gjuhës teatrorë në pjesë teatrale, që fillojnë pikërisht me lojën me role.

*Kjo shkallë kulmon me një shfaqje të thjeshtë ku përbëlidhen elementet e punuara e zhvilluara gjatë orëve mësimore, në një mini spektakël gjithëpërfshirës.*

##### **Rezultatet e të nxënët për kompetencat e lëndës:**

- Krijimi veprave teatrorë:*** Zbulon dhe identifikon elementet teatrorë në mjedisin e tyre dhe në skenë; identifikon forma të interpretimit dhe krijimit të simboleve, që janë edhe elemente të gjuhës teatrorë; demonstron zbatimin e elementeve të interpretimit gjatë improvizimit dhe krijimit të modeleve interpretuese.

- **Interpretimi i veprave teatrorë:** interpreton me elemente të gjuhës teatrorë, respekton konvencionin, sillet sipas rolit, krijon në varësi të rrethanës e personazhit, improvizon nëpërmjet trupit të tij, për të demonstruar elementët e përcjellë teatrorë në këtë fazë.
- **Vlerësimi i veprave teatrorë:** flet qartë duke përdorur elementet teatrorë gjatë shpjegimit të interpretimit; fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë teknik për t'u shprehur në mënyrë artistike; shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet e interpretimit.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<b>KLASAE PESTË</b>	
<p><b>Të besuarit në aktrrim:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Besimi tek loja</li> <li>- Besimi tek personazhi që i caktojnë</li> <li>- Të luash si për herë të parë</li> <li>- Dëgjimi</li> <li>- Marrëdhënia shkak-pasojë</li> <li>- Interpretimi në ansambël</li> </ul> <p><b>Improvizimi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aftësi improvizimi</li> <li>- Improvizimin në rrethana jetësore</li> <li>- Dëgjimi</li> <li>- Marrëdhënia shkak-pasojë</li> <li>- Interpretimi në ansambël</li> <li>- Teatri i rrugës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zbulon se që fëmijë ka besuar në rolin që i është caktuar në një lojë dhe e ka luajtur atë rol me besim deri në fund. Përpinqet ta vërë tani këtë në zbatim në mënyrë të ndërgjegjshme.</li> <li>- Zbulon se ka luajtur gjithmonë si për herë të parë, duke e mbajtur lojën gjithmonë të freskët. Përpinqet ta vërë tani këtë në zbatim në mënyrë të ndërgjegjshme.</li> <li>- Dëgjon me vëmendje se çfarë thotë tjetri për të reaguar sipas rrethanës dhe për t'iu përgjigjur me koherencë parafolësit, duke zhvilluar marrëdhënie të logjikshme shkak-pasojë.</li> <li>- Krijon individualisht duke konsideruar e respektuar të tjerët drejt një krijimi të përbashkët.</li> <li>- Zbulon aftësitë vetjake për të improvizuar dhe kupton se improvizimi është formë krijimi artistik.</li> <li>- Identifikon improvizimin në rrethana të ndryshme jetësore.</li> <li>- Dëgjon me vëmendje se çfarë thotë tjetri për të reaguar sipas rrethanës dhe për t'iu përgjigjur me koherencë parafolësit, duke zhvilluar marrëdhënie të logjikshme shkak-pasojë.</li> </ul>

- Krijon individualisht duke konsideruar e respektuar të tjerët drejt një krijimi të përbashkët.
- Mëson për teatrin e rrugës, artin e të improvizuarit brenda një rrethane të caktuar.

## 1.2 Tematika: Teknika dhe pjesë teatrore

### Përshkrimi i tematikës:

Ndërsa eksploroni, zbulon dhe ndërgjegjësohet mbi tipare të caktuara të aktrimit e të skenës, përmes kësaj tematike ai fillon të zbatojë konkretisht përmes teknikave dhe proceseve teatrore këto elemente, që zhvillohen falë gjuhës teatrore. Proseset teatrore që zhvillohen dhe përshkojnë teatrin në tërësi janë: interpretimi sipas logjikës, zhanrit, improvizimi, imagjinata skenike, krijimi në elemente teatrore, etj.

Kjo tematikë do të ndalet kryesisht në procesin e aktrimit të thjeshtë, besimit tek loja, improvizimit, dëgjimit, njekjes së procesit shkak-pasojë, por edhe me vlerësimin e interpretimit të tyre. Përmes lojës, kjo tematikë ka si qëllim t'u mësojë nxënësve besimin në aktrim, përdorimin e imagjinatës së krijimit të kësaj gjinie dhe raportet e sakta shkak-pasojë. Loja, rituali dhe improvizimi kanë ndikim të fortë dhe besueshmëri tek fëmijët. Nëpërmjet tyre ata hulumtojnë në terren të njobur kombëtar, me lojërat e ritualet e trashëguara nga folklori, por edhe me improvizime me maska, që janë shumë afër natyrës së lojërave të tyre me karaktere të trilluara. Materialetduhet jenë didaktike me vlerë krijimi artistik, që edukojnë ndërgjegjësim, aftësim e vlera të caktuara, ndaj tematika e tyre është e detyrueshme. Pjesët në këtë fazë duhet të jenë të thjeshta në raport me detyrat e ngarkuara dhe synimin e arritur. Kjo linjë ka si qëllim edhe njojjen me mjete e elemente historike e konkrete skenike.

### Rezultatet e të nxënësit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi teatror:** njeh elemente të aktrimit e të skenës, që janë edhe elemente të gjuhës teatrore; zbulon dhe identifikon këto elemente në mjeshterin e tyre; demonstron zbatimin me ndërgjegje të këtyre elementeve gjatë lojës ose interpretimit të këtyre pjesëve të thjeshta.
- **Interpretimi teatror:** interpreton duke respektuar teknikën e interpretimit përmes rregullave të përcaktuara; interpreton sipas tematikës: lojë fëmijësh, improvizim karakteri imagjinari, ritual; interpreton duke respektuar elemente teatrore dhe duke krijuar në çdo element inskenimin e tyre
- **Vlerësimi teatror:** shpreh qartë mendimin e vet emocional për pjesë teatrore apo elementet artistike, duke përdorur gjuhën e fushës gjatë shpjegimit; e përjeton krijimin, respekton interpretimin e shokëve dhe punën në ansambël; respekton krijime teatrore të kulturave të tjera.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<b>KLASAE PESTË</b>	
<p><b>Lojë fëmijesh:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lojëra të thjeshta besueshmërie dhe karakteresh: “shkollash”, “shtëpiash”</li> </ul> <p><b>Improvizim me maska:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Improvizim në grup me maska me zgjedhje të lirë kafshësh apo personazhesh të trilluara</li> </ul> <p><b>Ritual:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këngë popullore humoristike dasme, ku nxënësit ndahen në dy grupe, për të interpretuar hidh-e-prit vargjet e njërsës prej dy palëve, në mbrojtje të dhëndrit a të nuses</li> </ul> <p><b>Regullat e interpretimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Besimi në rol.</li> <li>- Ruajtja e karakterit.</li> <li>- Dëgjimi i kujdeshëm.</li> <li>- Marrëdhënia shkak-pasojë.</li> <li>- Shqiptimi.</li> <li>- Interpretimi individual dhe në grup (kori).</li> </ul> <p><b>Mjetet trupore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sjelljet fizike sipas personazhit.</li> <li>- Komunikimi verbal sipas personazhit.</li> <li>- Ndrekja e logjikës së personazhit .</li> </ul>	<p>- Imiton personazhin që i kanë caktuar ose që ka zgjedhur, duke ndërruar rolet dhe duke provuar të mendojë sipas një tjetër karakteri: <i>si prindi, si fëmija, si mësuesi, si nxënësi, si një kafshë, si një personazh i trilluar, si krushqia e nuses, si krushqia e dhëndrit, etj.</i></p> <p>- Dëgjon dhe reagon sipas rrëthanave.</p> <p>- Zbulon aftësitë krijuese vetjake, duke eksperimentuar me improvizimin ose me përbushjen e karakterit.</p> <p>- Interpreton role të ndryshme.</p> <p>- Kuption rregullat e interpretimit dhe zbaton disiplinën skenike.</p> <p>- Shoqëron të tjerët në krijimin në ansambël.</p> <p>- Interpreton duke u shprehur qartë e sipas personazhit.</p>

### 1.3 Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria

#### Përshkrimi i tematikës:

Ndërsa punon konkretisht me materiale të thjeshta, mëson dhe merr informacione mbi historikun e lindjes së teatrit, nevojën njerëzore për ta pasur atë pranë gjatë historisë, zhvillimin e zhanreve, specifikat e tyre, historinë e elementeve teatrore, si kostumet, maskat, skenografia, lidhja e fortë midis shoqërisë e teatrit dhe se si evoluon ai në stade të caktuara shoqërore, materiale folklorike që lidhen ngushtë me teatrin etj.

Kjo tematikë do të ndalet në koncepte të thjeshta të teatrit, që lidhen me këto pjesë teatrore ose që marrin rrugë prej tyre, për t'u dhënë fëmijëve një panoramë më të gjerë historike e shoqërore. Përmes lojës dhe ritualit fëmijët njihen me pasuri folklorike vendase, përmes improvizimit hulumtojnë më tej dhe përdorin dijet e tyre të mara nga një zhanër tjetër i njohur i folklorit, siç janë përrallat e legjendat dhe sillen si personazhe që i kanë njohur nëpërmjet tyre. Këtu aplikohen edhe kostume historike kombëtare, fjalor populor, të dhëna mbi lidhjet e para të shoqërisë së hershme shqiptare me format primitive teatrore, siç është rituali.

Maskat ndihmojnë në njohjen e nxënësit me maskat rituale nëpër botë, me zhanre të tjera të njohura që përdorin maska si *Commedia dell'arte*, e cila ndërthur edhe elementet e improvizimit dhe falë kësaj marrin edhe të dhëna mbi lindjen e teatrit botëror në antikitet, specifika e tipare të tij, historinë, funksionin e karakteristikat elementeve pamore siç janë skenografia e kostumet, etj.

#### Rezultatet e të nxënëtit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi i veprave teatrore:** mëson të kuptojë disa zhanre të caktuara teatrore, arrin të identifikojë e të konsolidojë lidhjen mes folklorit dhe teatrit, duke përjetuar ndërgjegjësim kombëtar, përdor imazhe që i lidhen me fëmijërinë, krijon sipas zhanrit të caktuar, me elemente përkatëse teatrore
- **Interpretimi i veprave teatrore:** interpreton sipas zhanrit, punon në grup kur është e nevojshme, interpreton sipas rrethanave historike e shoqërore që kërkon pjesa, vlerëson interpretimin e të tjerëve
- **Vlerësimi i veprave teatrore:** arrin të dallojë disa zhanre të caktuara, elemente teatrore të këtyre zhanreve, gjuhën e tyre komunikuese e artistike, shpreh qartë mendimin e qëndrimin e vet në lidhje me to, është në gjendje të kuptojë lidhjen mes një materiali dhe interpretimit, ku ton dhe respekton kultura të tjetra dhe një krijim të caktuar artistik në një kontekst të caktuar, duke u përpjekur të evidentojë elemente të ngjashme apo të ndryshme në kulturën e tij.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitëpër realizimin e kompetencave të lëndës KLASA E PESTË
<p><b>Skenografia / rekuizita, kostumet/ maskat:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rol i skenografisë dhe i objekteve skenike</li> <li>- Rol i kostumeve</li> <li>- Rol i maskave</li> <li>- Rrethanat historike</li> </ul> <p><b>Gjini të interpretimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Loja</li> <li>- Rituali</li> <li>- <i>Commedia dell'arte</i></li> <li>- Antikiteti</li> <li>- Koret në teatër</li> <li>- Komedia</li> <li>- Folklori</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson për rolin e skenografisë në krijimin e një rrethane e atmosfere të besueshme në teatër, apo se mund të jetë edhe krijim artistik simbolik që përçon frymën e një vepre. Mëson për rolin dhe rëndësinë e objekteve skenike.</li> <li>- Mëson për rolin e kostumeve dhe të maskave në ritual dhe teatër.</li> <li>- Mëson për rrethanat historike që mund të përcillen nëpërmjet një kostumi, skenografisë apo elementeve skenike.</li> <li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin qëndrime personale ndaj “lojës së fëmijëve” si një formë elementare aktrimi.</li> <li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin dije personale ndaj “ritualit” si një formë primitive aktrimi.</li> <li>- Merr informacione mbi rrymën dhe specifikat e <i>Commedia dell'arte</i>.</li> <li>- Merr informacione mbi mënyrën se sa i rëndësishëm ishte teatri në Antikitet dhe se si ishte i organizuar ai, cila ishte rëndësia e korit në këtë teatër dhe si aktrohej.</li> <li>- Merr informacione mbi lindjen e komedisë.</li> <li>- Evidenton lidhjen e folklorit me krijimet primitive teatrore dhe krijon sipas njohive të veta të natyrshme folklorike.</li> <li>- Dallon gjinitë e shpjeguara dhe elementet që i karakterizojnë.</li> </ul>
<p><b>Qëndrime dhe vlera:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Paraqet kuriozitet për interpretimin, pjesët teatrore apo elementet skenike.</li> <li>- Eksploron dhe zbulon elementet dhe veprat teatrore, duke shprehur mendimin e vet ndaj këtyre elementeve.</li> <li>- Kuption karakteristikat e interpretimit.</li> </ul>	

- Shpreh idetë e veta për teatrin.
- Shprehet artistikisht për një pjesë teatrore.
- Demontron vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike.
- Ka dëshirë për t'u shprehur dhe komunikuar në mënyrë të pavarur.
- Merr pjesë aktive në veprimitaritë teatrore vetëm dhe në grup.
- Përdor imagjinatën dhe krijimtarinë për të krijuar dhe interpretuar.
- Demontron këmbëngulje dhe disiplinë skenike në krijimet teatrore.
- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjera në një veprimitari teatrore.
- Respekton diversitetin e kulturave të ndryshme.
- Tregon respekt për veten dhe të tjera.
- Mban qëndrim ndaj veprave ose elementeve të caktuara teatrore.
- Njeh dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe trashëgiminë e kulturave të tjera.
- Demontron fryshtë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë interpretimit apo krijimit teatror
- Demontron përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

## **REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE**

### **SHKALLA E TRETË: KLASA E GJASHTË**

#### **1.4 Tematika : Gjuha dhe komunikimi teatror**

##### **Përshkrimi i tematikës:**

Vazhdimi i interpretimit duke marrë role dhe pjesë të thjeshta, që çlironjë krijimtarinë, por tani bazuar mbi materiale konkrete që duhen interpretuar. Atafillojnë të kuptojnë interpretimin e një materiali të shkuar, sipas bazës logjike, duke shmangur interpretimin e gabuar me kantilenë që trashëgohet nga klasa më të hershme. Duke qenë se fëmija është eksposuar edhe më herët me poezinë, ata fillojnë të interpretojnë poezi e fabula të thjeshta me karaktere kafshësh, për të kaluar gradualisht tek poezi më të përgjithshme dhe tek tregime apo përralla të thjeshta. Kështu nxënësit fillojnë të zhvillojnë procese si: *logjika, artikulimi, e folura skenike dhe krijimi i e karaktereve* brenda një materiali të caktuar. Gjithashtu, në këtë fazë do të eksplorojnë edhe me role të thjeshta regjisoriale, për t'u shtuar shfaqjeve finale edhe elemente artistikë të kostumeve, muzikës, skenografisë, ndriçimit, duke inkuadruar në këto role nxënës me prirje më të larta në këtë fushë se sa në interpretim, duke stimuluar punën në ansambël për krijimin e një përvoje skenike.

##### **Rezultatet e të nxënët për kompetencat e lëndës:**

- ***Krijimi i veprave teatrore:*** Kupton logjikën e një materiali dhe interpreton sipas kësaj logjike, kupton theksat logjikë, shprehjen sipas një karakteri, lojën sipas tij, krijimin e një pune të thjeshtë “regjisoriale”, demonstron respektim të disiplinës skenike dhe punën në ansambël.
- ***Interpretimii veprave teatrore:*** interpreton me elementet të gjuhës skenike, interpreton me theksa logjikë, krijon figurë brenda tipareve të karakterit, ndërsa tregon një histori nëpërmjet tij, zbaton logjikën në interpretim.

- **Vlerësimi i veprave teatrore:** flet qartë duke përdorur elementet teatrore gjatë shpjegimit të interpretimit; fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë teknik për t'u shprehur në mënyrë artistike; shpjegon me fjalë të thjeshta përfjetimet e interpretimit.

KLASA E GJASHTË	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<p><b>Interpretimi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Interpretimi i karaktereve të thjeshta në një material të caktuar</li> <li>- Respektimi i ngjarjes dhe besimi në lojë</li> <li>- Interpretimi i materialeve poetike</li> <li>- Interpretimi me logjikë</li> <li>- Dëgjimi.</li> <li>- Marrëdhënia shkak-pasojë</li> <li>- Interpretimi në ansambël</li> </ul> <p><b>Organizmi regjisorial:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Caktimi i detyrave e roleve sipas aftësive</li> <li>- Zbatimi i roleve</li> <li>- Ndihma reciproke në krijimin artistik</li> <li>- Vëmendja ndaj më shumë elementeve skenike.</li> </ul>	<p><b>Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijon një karakter mbi një material të paracaktuar, por që ashtu si tek improvizimi e rituali e luan si për herë të parë.</li> <li>- Zbaton parimet e besimit në lojën që po bën.</li> <li>- Kuption logjikën edhe brenda tekstit poetik dhe e zbaton atë në interpretim.</li> <li>- Çon më tej aftësinë e dëgjimit të partnerit dhe të veprimit shkak-pasojë.</li> <li>- Zhvillon më tej përqendrimin e disiplinën skenike.</li> <li>- Krijon individualisht duke konsideruar e respektuar të tjerët drejt një krijimi të përbashkët.</li> <li>- Merr përsipër të kuptojë natyrën e grupit të caktuar se cili është më i përshtatshëm për secilën detyrë dhe pse. Argumenton me shokët për këtë.</li> <li>- Mbikëqyr apo respekton detyrën e roleve të caktuara.</li> <li>- Respekton mendimin krijues të të gjithëve drejt një krijimi sa më të mirë në ansambël.</li> <li>- Zgjeron në bashkëpunim aftësitë krijuese në grup, sipas elementeve.</li> <li>- Vë në zbatim mjetet e komunikimit skenik, për të mbërritur një pjesë sa më të arirë teatrore.</li> </ul>

## 1.5 Tematika: Teknika dhe pjesë teatrore

Përkthimi i tematikës:

Ndërsa zhvillon më tej aftësi për të cilat është ndërgjegjësuar në shkallën e parë, tani shkon më tej me materiale të një shkalle më të lartë vështirësie, pavarësisht se janë materiale që tani i njeh dhe i interpreton prej vitesh. Këto janë fabulat, poezitë me karaktere kafshësh, poezitë e thjeshta dhe përrallat apo legjendat. Tani nxënësi fillon të zbatojë krijimin e tij improvizues të një karakteri të trilluar mbi një material të strukturuar, që kërkon të kuptuar dhe të interpretuar logjik, pa anashkaluar as edhe një çast punën në ansambël, dëgjimin e partnerit dhe marrëdhënien shkak-pasojë. Tani karakteri fillon të ndërtohet në rrethana dhe në një fabul të paracaktuar që në krye të kohës etj.

Kjo tematikë do të zhvillojë edhe aftësi të tjera teatrore, si janë roli i regjisoret, i aktorëve, i detyrave të tjera skenike, si skenografi, kostumografi, përgjegjësi i zhurmave e i muzikës, duke ndihmuar një krijimtari më të plotë, në më shumë elemente teatrore.

Kjo fazë përfshin edhe hulumtime më të gjera në materiale nga ana e nxënësve, në kërkim të një poezie, fabule, apo përralle që u pëlqen ta interpretojnë, pavarësisht se në fund do të varen nga mësuesi. Kjo do të sjellë më shumë njoħuri mbi këto materiale, apo më shumë kërkime mbi kostumet, muzikën e skenografinë që mund të përshtatin apo se si t'i realizojnë me mjete të thjeshta, duke sjellë njoħuri edhe në fusha të tjera që lidhen me teatrin. Materialetduhet jenë didaktike me vlerë krijimi artistik, që edukojnë ndërgjegjësim, aftësim e vlera të caktuara, ndaj tematika e tyre është e detyrueshme. Pjesët në këtë fazë duhet të jenë në raport me detyrat e ngarkuara dhe synimin e arritur. Kjo linjë ka si qëllim edhe njoħjen me mjete e elemente zhanri e konkrete skenike.

#### **Rezultatet e të nxënënit për kompetencat e lëndës:**

- ***Krijimi veprave teatrore:*** zhvillon më tej elemente të aktrimit e të skenës, që janë edhe elemente të gjuhës teatrore; zbulon dhe identifikon këto elemente në mjeshterin e tyre; demonstron zbatimin me ndërgjegje të këtyre elementeve gjatë lojës ose interpretimit të këtyre materialeve, krijon elemente artistike që përplotësojnë imazhe regjisoriale të shfaqjes, argumenton pse duhet apo nuk duhet të ketë një detyrë ose një rol të caktuuar në shfaqje.
- ***Interpretimi i veprave teatrore:*** interpreton duke respektuar teknikën e interpretimit përmes rregullave të përcaktuara; interpreton sipas tematikës: fabul / poezi me karaktere, poezi, tregim/ përrallë me karaktere; interpreton duke respektuar elemente teatrore dhe duke krijuar në çdo element inskenimin e tyre
- ***Vlerësimi i veprave teatrore:*** shpreh qartë mendimin e vet emocional për pjesë teatrore, koncepte regjisoriale apo elementet artistike, duke përdorur gjuhën e fushës gjatë shpjegimit; e përjeton krijimin, respekton interpretimin e shokëve dhe punën në ansambël; respekton krijime teatrore të kulturave të tjera.

## KLASA 6 / SEMESTRI I

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitëpër realizimin e kompetencave të lëndës
<p><b>Poezi me karaktere kafshësh me dialog ose fabul</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijim karakteri kafshe mbi një material të caktuar</li> </ul> <p><b>Poezi e thjeshtë :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Interpretim poezie të thjeshtë</li> </ul> <p><b>Përralla ose tregime të thjeshta me personazhe:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Interpretim i një përralle me personazhe, inskenuar me ‘regisor’ dhe elemente regjisoriale</li> </ul> <p><b>Rregullat e interpretimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ruajtja e karakterit</li> <li>- Respektimi i ngjarjes</li> <li>- Luajtja si për herë të parë</li> <li>- Dëgjimi i kujdeshëm</li> <li>- Marrëdhënia shkak-pasojë</li> <li>- Shqiptimi</li> <li>- Krijimi individual dhe në grup</li> </ul> <p><b>Mjetet trupore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sjelljet fizike sipas personazhit</li> <li>- Komunikimi verbal sipas personazhit</li> <li>- Ndrekja e logikës së personazhit</li> </ul> <p><b>Tiparet skenike:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcaktimi i roleve dhe detyrave</li> <li>- Argumentimi i tyre</li> </ul>	<p><b>Shkathësitëpër realizimin e kompetencave të lëndës</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijon personazhin që i kanë caktuar ose që ka zgjedhur, duke krijuar një figurë origjinale mbi një material të paracaktuar, me strukturë të caktuar.</li> <li>- Dëgjon dhe reagon sipas rrethanave.</li> <li>- Kupton theksat logjike dhe i vë në zbatim në interpretim.</li> <li>- Artikulon qartë fjalët.</li> <li>- Zbulon aftësitë krijuese vetjake, në role apo detyra të caktuara ose të zgjedhura skenike.</li> <li>- Hulumton gamë të gjerë materialesh letrare për të gjetur atë që i përshtatet në interpretim.</li> <li>- Kupton rregullat e interpretimit dhe të detyrës skenike dhe zbaton disiplinën skenike.</li> <li>- Shoqëron të tjerët në krijimin në ansambël.</li> </ul>

- |                       |  |
|-----------------------|--|
| - Respektimi i roleve |  |
|-----------------------|--|

## 1.6 Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria

### Përshkrimi i tematikës:

Ndërsa punon konkretisht me materiale pak më specifike zhvillon më tej njohuritë dhe informacione mbi historikun e teatrit, specifika të tij, por edhe materiale të tjera letrare që lidhen fort me teatrin; zhvillon dijet e tij mbi sensin logjik, ndjekjen e tij në interpretim, mesazhet artistike që përcjell teatri dhe rolin e tyre në histori, politikë e shoqëri; mëson më shumë mbi poezinë e materialet e tjera të interpretueshme, për specifikat e tyre, për zhanre të tjera si drama e tragjedia, për rëndësinë e regjisurës në teatër, cilat janë disa nga elementet skenike që i jepin fytyrë regjisoriale një shfaqjeje etj.

Kjo tematikë do të ndalet në koncepte më të përparuara të teatrit, që lidhen me këto pjesë teatrore ose që marrin rrugë prej tyre, për t'u dhënë fëmijëve një panoramë më të gjerë historike e shoqërore. Përmes përrallës e poeziës ritualit fëmijët nijhen me pasuri folklorike vendase, por edhe me pasuri krijuar nga bota, ata ndërthurin dijet e shkallës së parë ku kanë improvizuar me karaktere, me një strukturë të re dhe të përcaktuar dramaturgjike, duke ndërthurur natyrshëm shkallën e parë me një material me ngjarje të përcaktuar apo menatyrë specifike siç është poezia. Në këtë fazë aplikohen edhe më shumë elemente regjisoriale, ku mund të përfshihen kostume historike kombëtare apo nga bota, muzikë nga trevat tona apo kompozitorë të huaj, elemente skenografie më të përpunuara dhe tentativa latente konceptesh regjisoriale dhe mini-shfaqjesh të organizuara në ansambël.

Duke hyrë në shpjegimin e poeziës, mësuesi shpjegon edhe zhanre të tjera më të ndërlikuara se komedia, që u shpjegua në fazën e parë, si janë tragjedia e drama, si ka ndikuar teatri në historinë botërore e rende politike, por edhe fakte interesante mbi historinë e teatrit, si kuriozitete mbi faktin se dikur rolet e meshkujve luheshin nga femrat, që shfaqja Rikardi II u dha para komplotit për rrëzimin e Mbretëreshës Elizabetë, etj .., që tregojnë peshën e madhe që ka teatri, por për t'ua bërë sa më të dashur e më interesant fëmijëve këtë zhanër artistik.

### Rezultatet e të nxënësit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi teatror:** mëson më kuptojë edhe zhanre të tjera teatrore apo në fusha të tjera të letërsisë, arrin të identifikojë e të konsolidojë lidhjen mes letërsisë e teatrit, duke përjetuar ndërgjegjësim kombëtar, ndërkombëtar e kulturor, përdor imazhe që i lidhen me fëmijërinë, zhvillon më tej

aftësitë e krijuara në fazën e parë, krijon sipas zhanrit të caktuar, me elemente përkatëse teatrore.

- **Interpretimi teatror:** interpreton sipas zhanrit, punon në grup, interpreton sipas rrethanave historike e shoqërore që kërkon pjesa, vlerëson interpretimin e të tjerëve, respekton rolin apo detyrat e caktuara që i janë ngarkuar.
- **Vlerësimiteatror:** arrin të dallojë disa zhanre të caktuara, elemente teatrore të këtyre zhanreve, gjuhën e tyre komunikuese e artistike, shpreh qartë mendimin e qëndrimin e vet në lidhje me to, është në gjendje të kuptojë lidhjen mes një materiali dhe interpretimit, kuption dhe respekton kultura të tjera dhe një krijim të caktuar artistik në një kontekst të caktuar, duke u përpjekur të evidentojë elemente të ngjashme apo të ndryshme në kulturën e tij, argumenton mbi tipare të caktuara kulturore, me një gjuhë më të pasur teknike.

### KLASA E GJASHTË / SEMESTRI I

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitëpër realizimin e kompetencave të lëndës
<b>Teatri në kontekst historik:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lloji i interpretimit</li> <li>- Zhvillime të teatrit në histori</li> <li>- Zhvillime të zhanreve të të shkruarit në dramaturgji</li> <li>- Mesazhet që përcjell teatri</li> <li>- Zhvillimi i regjisurës</li> </ul>	<b>Shkathësitëpër realizimin e kompetencave të lëndës</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mëson se në kohëra të ndryshme në teatër është interpretuar ndryshe.</li> <li>- Mëson se në kohëra të ndryshme për teatrin është shkruar në forma të tjera (vargje, tekste, dramaturgji me gjuhë vepruese).</li> <li>- Mëson se teatri përcjell mesazhe të forta shoqërore e politike, por në forma artistike</li> <li>- Mëson se me kalimin e viteve në teatër filloi të zhvillohej regjisura, që pasuroi elementet skenike.</li> <li>- Mjetet e krijimit regjisorial në histori me shembuj.</li> <li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin qëndrime personale ndaj poezisë si gjini dhe si interpretim.</li> <li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin qëndrime personale ndaj fabulës si gjini dhe si interpretim.</li> </ul>
<b>Gjini të interpretimit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Poezia</li> <li>- Fabula</li> <li>- Tregimi</li> <li>- Përralla</li> </ul>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drama</li> <li>- Tragjedia</li> <li>- Folklori</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin qëndrime personale ndaj tregimit si gjini dhe si interpretim.</li> <li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin qëndrime personale ndaj përrallës si gjini dhe si interpretim.</li> <li>- Merr informacione mbi rrymën dhe specifikat e dramës e tragjedisë.</li> <li>- Merr informacione mbi rëndësinë e teatrit në histori.</li> <li>- Çon më tej ndërgjegjësimin mbi lidhjen e folklorit (përralla, fabula) me interpretimin teatror dhe krijon sipas njohjeve të veta të natyrshme folklorike.</li> <li>- Dallon gjinitë e shpjeguara dhe elementet që i karakterizojnë.</li> <li>- Mëson mbi lindjen dhe zhvillimin e regjisurës dhe rëndësinë e saj.</li> </ul>
--	---

#### **Qëndrime dhe vlera:**

- Paraqet kuriozitet për interpretimin, pjesët teatrore apo elementet skenike.
- Eksploron dhe zbulon elementet dhe veprat teatrore, duke shprehur mendimin e vet ndaj këtyre elementeve.
- Kupton karakteristikat e interpretimit.
- Shpreh idetë e veta për teatrin.
- Shprehет artistikisht për një pjesë teatrore.
- Demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike.
- Ka dëshirë për t'u shprehur dhe komunikuar në mënyrë të pavarur.
- Merr pjesë aktive në veprimtaritë teatrore vetëm dhe në grup.
- Përdor imagjinatën dhe krijimtarinë për të krijuar dhe interpretuar.
- Demonstron këmbëngulje dhe disiplinë skenike në krijimet teatrore.
- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjera në një veprimtari teatrore.
- Respekton diversitetin e kulturave të ndryshme.
- Tregon respekt për veten dhe të tjërët.

- Mban qëndrim ndaj veprave ose elementeve të caktuara teatrote
- Njeh dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe trashëgiminë e kulturave të tjera.
- Demontron frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë interpretimit apo krijimit teatror
- Demontron përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuese dhe interpretuese.

## **2. REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE**

### **SHKALLA E TRETË: KLASA E GJASHTË, SEMESTRI II**

#### **2.1.Tematika: Gjuha dhe komunikimi teatror**

##### **Përshkrimi i tematikës:**

Nxënësit shkojnë në një shkallë më të përparuar të gjuhës gjithëpërfshirëse teatrote. Tani ai/ajo fillon të eksperimentojë edhe me elemente të tjera teatrote, të cilat nuk lidhen domosdoshmërisht me fjalën e folur, siç janë etydi dhe krijimi simbolik, krijon me baza konvencionale për të kuptuar dhe zbatuar edhe elemente speciale teatrote, siç është “sikur”-i. Kështu nxënësi çon në një shkallë më të avancuar njohuritë e tij mbi gjuhën skenike, fillon të mendojë për krijime më të avancuara dhe më të plota skenike, mëson të flasë edhe vetë me gjuhën e këtyre elementeve. Në këtë fazë nxënësit do të fillojnë të punojnë edhe me pjesë të thjeshta dramaturgjike, çka do të sjellë njohuri të përparuara edhe në këtë zhanër, pasi do t'u kërkohet të lexojnë nga kjo gjini për të gjetur pjesë të përshtatshme (të cilat më pas do të sugjeroohen nga mësuesi). Edhe ana regjisoriale e shfaqjes do të çohet një hap më tej, duke e plotësuar më shumë me elemente regjisoriale, drejt tendencës për t'u kulmuar me një shfacje të plotë në elemente në përfundim të semestrit, duke stimuluar punën në ansambël për krijimin e një përvoje sa më të pasur skenike, duke konsoliduar praktikisht njohuritë e marra deri më tani.

**Rezultatet e të nxënësit për kompetencat e lëndës:**

- **Krijimi i veprave teatrore:** Kupton se si funksionon etydi dhe materiali dramaturgjik dhe interpreton sipas kërkesave të tyre, kupton konvencionin dhe “sikur”-in, lojën teatrale sipas një karakteri, krijimin e një pune më të plotë në konceptin “regjisorial”, demonstron respektim të disiplinës skenike dhe punën në ansambël.
- **Interpretimi i veprave teatrore:** interpreton me elementet të gjuhës skenike, interpreton sipas kërkesave të dramaturgjisë e të simbolikës teatrore, krijon figurën brenda tipareve të karakterit, zbaton logjikën në interpretim, dëgjon dhe reagon sipas parimit shkak-pasojë.
- **Vlerësimi i veprave teatrore:** flet qartë duke përdorur elementet teatrore gjatë shpjegimit të interpretimit; fillon të përdorë një fjalor të thjeshtë teknik për t'u shprehur në mënyrë artistike; shpjegon me fjalë të thjeshta përjetimet e interpretimit dhe të elementeve skenike.

**KLASA 6 / SEMESTRI II**

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitëpër realizimin e kompetencave të lëndës
<b>Interpretimi:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Interpretimi pa fjalë</li><li>- “Sikur”-i</li><li>- Interpretimi dramaturgjik</li><li>- Respektimi i ngjarjes dhe besimi në lojë</li><li>- Dëgjimi</li><li>- Marrëdhënia shkak-pasojë</li><li>- Interpretimi në ansambël</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Krijon pa fjalë.</li><li>- Krijon duke përdorur “sikur”-in.</li><li>- Krijon duke përdorur konvencionin teatror.</li><li>- Krijon një karakter dhe marrëdhënie mbi një material dramaturgjik.</li><li>- Kupton logjikën e tekstit dramaturgjik dhe e zbaton atë në interpretim.</li><li>- Çon më tej aftësinë e dëgjimit të partnerit dhe të veprimit shkak-pasojë.</li><li>- Zhvillon më tej përqendrimin e disiplinën skenike.</li><li>- Krijon individualisht duke konsideruar e respektuar të tjerët drejt një krijimi të përbashkët.</li><li>- Merr përsipër të kuptojë natyrën e grupit të caktuar se cili është më i përshtatshëm për secilën detyrë dhe pse. Argumenton me shokët për këtë.</li></ul>
<b>Organizmi regjisorial:</b>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Caktimi i detyrate e roleve sipas aftësive</li> <li>- Zbatimi i roleve</li> <li>- Zbatimi i elementeve më të plota skenike</li> <li>- Ndihma reciproke në krijimin artistik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbikëqyr apo respekton detyrën e roleve të caktuara.</li> <li>- Respekton mendimin krijues të të gjithëve drejt një krijimi sa më të mirë në ansambël.</li> <li>- Zgjeron në bashkëpunim aftësitë krijuese në grup, sipas elementeve.</li> <li>- Vë në zbatim mjetet e komunikimit skenik, për të mbërritur një pjesë sa më të arriрë teatrore</li> </ul>
---	--

## 2.1.Tematika: Teknika dhe pjesë teatrore

### Përshkrimi i tematikës:

Ndërsa zhvillon më tej aftësitë e tij, tani përballet me etydin, “sikur”-in, konvencionin dhe interpretimin dramaturgjik. Nxënësit tani do të përballen me etyde të thjeshta, do të përdorin imagjinatën për të krijuar rrethana ku një objekt e përdorin në tjetër funksion nga ai origjinal, do të luajnë me “sikur”-in dhe të gjitha ato që kanë mësuar deri tani do t'i aplikojnë fillimisht në pjesë të vogla me 1 akt për të mbërritur në një pjesë të tillë pak më të ndërlikuar, ku do të përfshihen elementet e aktrimit e ato të regjisurës që kanë mësuar deri tani, për të krijuar një shfaqje të plotë në ansambël.

Kjo fazë përfshin edhe hulumtime më të gjera në materiale nga ana e nxënësve, tani më specifike, pasi do të kërkojnë e do të lexojnë pjesë dramaturgjike, ndërsa mësuesi do të sjellë më shumë informacione mbi kokat më të rëndësishme të dramaturjisë dhe pjesët më të njobura në botë e bë vend, duke zgjeruar njoburitë e tyre mbi dramaturjinë dhe regjisurën, madje për këtë të dytën mund të sjellë edhe materiale krahasuese midis vënieve të ndryshme në skenë të së njëjtës pjesë.

Në varësi të repertorit të Teatrit Kombëtar mësuesi/ja i çon të shohin edhe një shfaqje, duke u shpjeguar konkretisht elementet, për të mbërritur sa më mirë në një qëllim final. Semestri mbylljet me vënien në skenë të një pjesë të njobur botërore ose shqiptare dramaturgjik, përshtatur për kapacitetin e nxënësve.

Materialetduhet jenë didaktike me vlerë krijimi artistik, që edukojnë ndërgjegjësim, aftësim e vlera të caktuara, ndaj tematika e tyre është e detyrueshme. Pjesët në këtë fazë duhet të jenë në raport me detyrat e ngarkuara dhe synimin e arritur. Kjo linjë ka si qëllim edhe njobjen me mjete e elemente zhanri e konkrete skenike.

### Rezultatet e të nxënët për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi i veprave teatrote:** zhvillon më tej elemente të aktrimit e të skenës, që janë edhe elemente të gjuhës teatrote; zbulon dhe identifikon këto elemente në mjeshterin e tyre; demonstron zbatimin me ndërgjegje të këtyre elementeve gjatë lojës ose interpretimit të këtyre materialeve, krijon elemente artistike që përplotësojnë imazhe regjisoriale të shfaqjes, argumenton pse duhet apo nuk duhet të ketë një detyrë ose një rol të caktuar në shfaqje.
- **Interpretimi i veprave teatrote:** interpreton duke respektuar teknikën e interpretimit përmes rregullave të përcaktuara; interpreton sipas tematikës: etyd, “sikur”, pjesë dramaturgjike; interpreton duke respektuar elemente teatrote dhe duke krijuar në çdo element inskenimin e tyre
- **Vlerësimi i veprave teatrote:** shpreh qartë mendimin e vet emocional për pjesë teatrote, koncepte regjisoriale apo elementet artistike, duke përdorur gjuhën e fushës gjatë shpjegimit; e përjeton krijimin, respekton interpretimin e shokëve dhe punën në ansambël; respekton krijime teatrote të kulturave të tjera.

KLASA E GJASHTË / SEMESTRI II	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
<b>Etyd me objekt / “sikur”-i:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mini-ngjarje me objekt jashtëfunksionit të tij original</li> <li>- Krijon me “sikur”</li> </ul>	<b>Poezi me karaktere kafshësh me dialog ose fabul, poezi e thjeshtë, përralla ose tregime të thjeshta me personazhe</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijon një rrethanë dhe një mini-ngjarje me një objekt, të cilin nuk e përdor në funksionin e tij original.</li> <li>- Krijon rrethana e mini-ngjarje me “sikur”.</li> <li>- Dëgjon dhe reagon sipas rrethanave.</li> <li>- Zhvillon aftësitë e i zbaton në interpretim.</li> <li>- Interpreton sipas parimeve të dramaturgjisë.</li> <li>- Artikulon qartë.</li> <li>- Zbulon aftësitë krijuarës vetjake, në role apo detyra të caktuara ose të zgjedhura skenike.</li> </ul>
<b>Pjesë dramaturgjike me 1 akt:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Interpretim dramaturgjik</li> <li>- Vënie regjisoriale</li> </ul>	
<b>Pjesë e përshtatur dramaturgjike :</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Interpretim dramaturgjik</li> <li>- Vënie regjisoriale</li> </ul>	
<b>Rregullat e interpretimit:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi konvencional</li> <li>- Krijimi me “sikur”</li> </ul>	

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i karaktereve më të plota</li> <li>- Interpretimi dramaturgjik</li> <li>- Luajta si për herë të parë</li> <li>- Dëgimi i kujdeshëm</li> <li>- Marrëdhënia shkak-pasojë</li> <li>- Shqiptimi</li> <li>- Krijimi individual dhe në grup</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hulumton gamë të gjerë materialesh letrare për të gjetur atë që i përshtatet në interpretim.</li> <li>- Kupton rregullat e interpretimit dhe të detyrës skenike dhe zbaton disiplinën skenike.</li> <li>- Shoqëron të tjerët në krijimin në ansambël.</li> </ul>
<p><b>Mjetet trupore:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sjelljet fizike sipas personazhit</li> <li>- Komunikimi verbal sipas personazhit</li> <li>- Ndjekja e logjikës së personazhit</li> </ul> <p><b>Tiparet skenike:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përcaktimi i roleve dhe detyrave</li> <li>- Argumentimi i tyre</li> <li>- Respektimi i roleve</li> </ul>	

## 2.1 Tematika: Historia, teatri dhe shoqëria

### Përshkrimi i tematikës:

Ndërsa punon konkretisht me materiale më të ndërlikuara zhvillon më tej njohuritë dhe informacione mbi historikun e teatrit, specifika të tij dhe vepra të njohura dramaturgjike, si shqiptare, edhe botërore; zhvillon dijet e tij mbi konvencionin, “sikur”-in e etydin në teatër, mënyrën e interpretimit dramaturgjik, mesazhet artistike që përcjell teatri dhe rolin e tyre në histori, politikë e shoqëri; mëson më shumë mbi dramaturgjinë e regjisurën, për specifikat e tyre, në teatër, për historinë e tyre etj.

Kjo tematikë do të ndalet në koncepte më të përparuara të teatrit, që lidhen me këto pjesë teatrore ose që marrin rrugë prej tyre, për t'u dhënë fëmijëve një panoramë më të gjerë historike e shoqërore. Përmes pjesëve dramaturgjike ata njihen me krijime botërore e vendase dhe përmes konvencionit e “sikur”-it zbulojnë aplikimin e tyre në historinë e teatrit. Në këtë fazë çohen edhe më tej elementet regjisoriale, duke pasuar edhe më shumë dijet mbi kostumet historike, muzikën, elementet skenografike, konceptin regjisorial me një shfaqje më të plotë, të organizuar në

ansambël.

Duke hyrë në shpjegimin e dramaturgjisë, mësuesi shpjegon konkretisht lidhje të saj me historinë botërore e rende politike.

#### Rezultatet e të nxënësit përkompeticat e lëndës:

- **Krijimi i veprave teatror:** mëson të njohë më thellë dramaturgjinë, arrin të identifikojë e të konsolidojë lidhjen mes letërsisë e teatrit, duke përjetuar ndërgjegjësim kombëtar, ndërkombëtar e kulturor, përdor imazhe që lidhen me imagjinatën, zhvillon më tej aftësitë e krijuara më herët, krijon sipas zhanrit të caktuar, me elemente përkatëse teatrore.
- **Interpretimi i veprave teatroke:** interpreton sipas zhanrit, punon në grup, interpreton sipas rrethanave historike e shoqërore që kërkon pjesa, vlerëson interpretimin e të tjerëve, respekton rolin apo detyrat e caktuara që i janë ngarkuar.
- **Vlerësimi i veprave teatroke:** arrin të dallojë disa zhanre të caktuara, elemente teatroke të këtyre zhanreve, gjuhën e tyre komunikuese e artistike, shpreh qartë mendimin e qëndrimin e vet në lidhje me to, është në gjendje të kuptojë lidhjen mes një materiali dhe interpretimit, kupton dhe respekton kultura të tjera dhe një krijim të caktuar artistik në një kontekst të caktuar, duke u përpjekur të evidentojë elemente të ngjashme apo të ndryshme në kulturën e tij, argumenton mbi tipare të caktuara kulturore, me një gjuhë më të pasur teknike.

#### KLASA E GJASHTË / SEMESTRI II

• Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës.	Shkathësitë për realizimin e kompetencave të lëndës.
Zhvillimi i dramaturgjisë	<ul style="list-style-type: none"><li>- Mëson se si është zhvilluar dramaturgja .</li><li>- Mëson mbi ndikimin e dramaturgjisë dhe lloje të ndryshme të saj.</li><li>- Mëson mbi konvencionin në teatër.</li><li>- Mëson mbi forma të tjera të interpretimit.</li><li>- Mëson mbi rëndësinë “sikur”-it.</li><li>- Mëson më tej mbi konceptin regjisorial.</li></ul>
Gjini të interpretimit:	<ul style="list-style-type: none"><li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin qëndrime personale ndaj dramaturgjisë si gjini</li></ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Etydi</li> <li>- “Sikur”-i</li> <li>- Pjesët dramaturgjike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>dhe si interpretim.</li> <li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin qëndrime personale ndaj konvencionit si mjet krijues skenik.</li> <li>- Merr informacione dhe shkëmben me mësuesin qëndrime personale ndaj “sikur”-it si mjet krijues skenik.</li> <li>- Merr informacione mbi rrymën dhe specifikat e dramaturgjisë.</li> <li>- Merr informacione mbi rëndësinë e teatrit në histori.</li> <li>- Çon më tej ndërgjegjësimin mbi lidhjen e dramaturgjisë vendase e botërore me interpretimin teatror dhe krijon me ndërgjegje sipas specifikave</li> <li>- Dallon gjinitë e shpjeguara dhe elementet që i karakterizojnë</li> <li>- Mëson mbi zhvillimin e regjisurës</li> </ul>
--	---

**Qëndrime dhe vlera:**

- Paraqet kuriozitet për interpretimin, pjesët teatrore apo elementet skenike.
- Eksploron dhe zbulon elementet dhe veprat teatrore, duke shprehur mendimin e vet ndaj këtyre elementeve.
- Kupton karakteristikat e interpretimit.
- Shpreh idetë e veta për teatrin.
- Shprehет artistikisht për një pjesë teatrore.
- Demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike.
- Ka dëshirë për t'u shprehur dhe komunikuar në mënyrë të pavarur.
- Merr pjesë aktive në veprimtaritë teatrore vetëm dhe në grup.
- Përdor imagjinatën dhe krijimtarinë për të krijuar dhe interpretuar.
- Demonstron këmbëngulje dhe disiplinë skenike në krijimet teatrore.
- Bashkëpunon vetëm dhe me të tjera në një veprimtari teatrore.
- Respekton diversitetin e kulturave të ndryshme.

- Tregon respekt për veten dhe të tjerët.
- Mban qëndrim ndaj veprave ose elementeve të caktuara teatrote
- Njeh dhe respekton trashëgiminë kulturore kombëtare dhe trashëgiminë e kulturave të tjera.
- Demontron frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie gjatë interpretimit apo krijimit teatror
- Demontron përqendrim dhe durim gjatë punëve krijuarës dhe interpretuesë.

#### **IV. Udhëzime metodologjike**

Përdorimi i metodologjive efikase nëprocesin e të nxënësit tëteatritështë kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë seilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të teatrit do të thotëqë nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata përfjetojnë dhe provojnë vetë dukuritë dhe fenomenet teatrote. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetencë të caktuar e cila arrihet nëpërmjet rezultateve të të nxënësit dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e teatrit, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimitari emocionale dhe fizike jo gjithmonë krejtësisht të vetëdijshme për nxënësit e kësaj grupmoshe. Çdo përbajtje dhe veprimitari mësimore teatrote është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potentialit të tyre intelektual/artistiknë shumë aspekte.

Mësimdhënia e teatrit, synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinën e gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhëniën dhe nxënien bazuar në kompetencë; mësimdhëniën me në qendër nxënësin dhe mësimdhëniene nxënien e integruar.

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përsa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj. Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënieς në mësimin e teatrit mban parasysh:

- kompetencat kryesoretë tënënxënët në teatër;

- lidhjen konceptuale,ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi içdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë skenike;
- rëndësinë e zbatimeve praktike skenike, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet e komunikimit e të kuptuarit në situata tëjetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve teatrore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- veçoritë e interpretimit në mënyrëindividuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së teatrit dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie emenduar dhe eplanifikuar siç duhet, krijon kushtet e nevojshme për njënxënie tësuksesshme dhelehtëson, si punën emësuesit, ashtu edhe atë tënëxënësit.Kompetencat teatrore dhe jo vetëm kjo lëndë janëtë përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënët që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhđervjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në teatër.

Gjithashtu,është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si: “Pse më pëlqen?”, “A është vënë në skenë siç duhet?”, “A është interpretuar mirë?” etj. Në këtë mënyrë ai nxitet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja. Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve (shkalla 2), diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave

skenike/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçë.

## V. Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënësit bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies,i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave.Informacioni i siguruar nga vlerësimii ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përbushjen e kompetencave,u jep mundësitet përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive skenike nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*p.sh. vetëvlerësimi, interpretimi i një sërë materialesh, portofol me punë artistike, prezantim me gojë, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.*)

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në teatër, ndryshe nga lëndët e tjera, mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës posedondhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale, por të bashkërenduara në një punë finale grupi. *Inkurajimi, imaginata, shprehja origjinale* dhe *krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi* dhe *presantimi* i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte.Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënësit dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave teatrore të nxënësve,përmes krijimit, interpretimit dhe vlerësimit. Arritjet në fushën e teatrit dhe të artevejanë si individuale ashtu edhe në kontributin e tyre të punës në ansambël, prandaj duhet edhe të vlerësohen në të dyja aspektet.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara,që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes *të interpretuarit, të krijuarit, të analizuarit* të *pjesëve artistike* etj.Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli i nxënësit, është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në teatër. Ai mund të përbajë krijime, organizime dhe projekte kurrikulare, prodhime të ndryshme në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj.

Vlerësimi i nxënësve në shkallën e parë, të dytë dhe të tretë bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

## VI. Materialedhe burime mësimore

Gjatë mësimit të teatrit për realizimin e kompetencave mësuesi përdormjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologjite nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm,krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologja ka një ndikim të madh në këtë fushë duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë shfaqje, muzikë, metoda si të bëjnë diçka, elemente artistike, informacione për teatrin, materiale letrare, duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e teatrit. Mësuesi përdorfjalë dhe fjali të qarta,të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër por të thjeshtë të gjuhës teatrore. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të tëmësuarit. Ai/ajo u prezanton/sqaron nxënësve përbajtjet caktuara ose shkathtësitë që ata duhet të interpretojnë.

Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të mediave detyra dhe projekte të ndryshme.

Teatri studiohet përmes njoħjes dhe përdorimit të mjeteve si shikim të shfaqjeve, kërkimi për elemente të nevojshme, që kérkon shfrytëzimin e luajtësve të mediave të ndryshme, TV, pajisje digitale si kompjuterët, etj.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet natyrore si:* vetë trupi i njeriut, zëri, etj.
- *Mjetet audio-vizuale si:* TV, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet,CD, DVD.

- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, libra jashtëshkollarë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme teatrore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për teatrin. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe interpretuese, si dhe në kryerjen e krijimeve të ndryshme.
- *Mjedisi mësimorsi:*(klasa,studio pune, ambient interpretimi etj.).